

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Pyllëzime me Akacie”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Punë Ndërtimi, 45000000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: 28 333 333 (njëzet e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **Lekë pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:*Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77,pika 1/b dhe pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 2/b dhe pika 3, neni 42të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).*

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare

(2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 1 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.*

2.3Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj

dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: *Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39 pika 5, neni 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”*

2.3.2 Operatori i shërbimit duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme (të përkthyer dhe të noterizuara):

- ISO 45001:2018 ose ekuivalente për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në qëllimin e të cilit të përfshihet objekti i këtij prokurimi.
- ISO 9001: 2015 ose ekuivalente për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, në qëllimin e të cilit të përfshihet objekti i këtij prokurimi.

Certifikatat e mesiperme duhet të jenë të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë). Certifikata të jetë e vlefshme dhe të ketë lidhje me objektin e prokurimit

Argumentim: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencat si më poshtë vijon:

- Licencën për shërbime profesionale për zbatime dhe projektme me Kod III.7.A (të vlefshme). Kjo Licencë garanton eksperiencën dhe profesionalizmin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: *Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve*

juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 30 punonjës. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet Vërtetimi nga Administrata Tatimore ku të tregohet numri i Punonjësve dhe Listë-pagesat për muajin e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ku citon se fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1(një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figuroje në listpagesat e mujit te fundit dhe Listë-pagesat për muajin e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ku citon se fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar gjatë muajit të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, specialistët e mëposhtëm:

- 1 Ing. Pyjesh, vërtetuar me Kontratë pune, Diplomë, çertifikatë të vlerësimit të ndikimit në mjedis, liçencë për shërbime profesionale për zbatime dhe projekte si detyrim i ligjit të pyjeve që për çdo ndërhyrje në objekte pyjore duhet të jetë i përfshirë një ing. Pyjesh.
- **5 (pesë) punonjës të çertifikuar për punimet në pyjevërtetuar me Kontratë pune të vlefshme, Certifikaten, e cila duhet te jete leshuara nga institucione publike/private te licensuara dhe te autorizuar me ligj.**

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ku citon se fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

• **2.3.7Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike**

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
	Kamionçinë kapaciteti mbajtës jo më pak se 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	1
	Makinë Pick Up 4x4 për terrene të vështira	Në pronësi ose me qira	1
	Fadromë me goma	Në pronësi ose me qira	1
	Autobot uji jo më pak se 7 ton	Në pronësi ose me qira	1

- Motorrsek për krasitje në lartësi;
 - Pajisje për kapjen e degëve në lartësi;
 - Shkallë për ngjitje në lartësi;
 - Gërshërë për prerje të qeskave;
 - Sharrë dore;
 - Cfurkë;
 - Vinç për prerje degësh në lartësi jo më pak se 10 m
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:
 - çertifikata e pronësisë;
 - leja e qarkullimit;
 - çertifikata e kontrollit teknik;
 - polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);
 - leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon:
 - kontrata e qirasë;
 - çertifikata e pronësisë së qiradhënësit;
 - leja e qarkullimit; çertifikata e kontrollit teknik;
 - polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni);
 - leje/çertifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / akt-zhdoganimi / faturë tatimore / çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të

disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e vlefshme.

- Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë për vendodhjen e mjeteve/pajisjeve të deklaruara, me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Argumentimi: *Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.*

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune.

- Në të gjitha rastet kur përdoret emri ose marka, njihet njëvlefshmëria apo barazvlefshmëria, ose ekuivalenti.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.